



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË



## **SHTOJCA 1.25**

**Rregullore për rregullat dhe standardet e përfitimit të së drejtës për vitin akademik sabatik**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË

**RREGULLORE**

**PËR**

**RREGULLAT DHE STANDARDET E PËRFITIMIT TË SË**

**DREJTËS PËR VITIN AKADEMIK SABATIK**

(Miratuar me Vendimin nr. 536, datë 10 /10 / 2019, të Senatit Akademik të UK-së



## **Neni 1** **Baza ligjore dhe objekti**

1. Kjo rregullore është hartuar në zbatim të nenit 63 të Ligjit nr. 80/2015, datë 22. 07. 2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenin 39, të Statutit të UK-së, si dhe në aktet e brendshme të Universitetit.
2. Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe i rregullimit të marrëdhënieve juridike dhe financiare mes palëve për periudhën e përdorimit të vitit akademik sabatik.

## **Neni 2** **Të përgjithshme**

1. Viti akademik sabatik është një periudhë e paguar shkëputjeje nga angazhimet në institucion, e dhënë për stafin akademik të kategorisë "Lektor" dhe "Profesor" për të punuar për përparimin e tij akademik. Dhënia e kësaj lejeje mbështet, gjithashtu, misionin e UK-së për të rritur njohjen ndërkombëtare në mësimdhënie dhe kërkim, si dhe angazhimin e tij për bashkëpunim me institucionet e tjera të arsimit të lartë, industrinë dhe shoqërinë civile.
2. Nëpërmjet lejes sabatike, UK u siguron anëtarëve të stafit akademik, të cilët përmbushin kriteret e përzgjedhjes, një mundësi për të rritur njohuritë dhe aftësinë e tyre për të kontribuar në veprimtaritë e ardhshme kërkimore dhe mësimore të universitetit, duke i kushtuar kohë kërkimit dhe publikimit të arritjeve shkencore dhe / ose përmirësimit të aftësive profesionale.
3. Gjatë lejes sabatike stafi akademik lirohet nga të gjitha detyrimet dhe angazhimet që rrjedhin nga organizimi i kohës vjetore të punës.
4. Viti akademik sabatik mund të përdoret edhe jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë.
5. Leja sabatike mund të merret vetëm nëse largimi i personelit akademik nuk pengon veprimtarinë e studentëve, personelit akademik apo të universitetit.
6. Të gjitha aplikimet për vitin sabatik duhet të shoqërohen me vlerësimin me shkrim të përgjegjësit të njësisë bazë.
7. Kohëzgjatja maksimale e vitit sabatik nuk do të kalojë dymbëdhjetë muaj për çdo periudhë shtatëvjeçare.
8. Drejtoria e burimeve njerëzore ngarkohet për të ruajtur në një regjistër të posaçëm elektronik të gjitha të dhënat për stafin e vlerësuar si fitues të vitit sabatik. Ky regjistër do të përmbajë të dhëna në lidhje me kohëzgjatjen e vitit sabatik dhe rregullimet e marrëdhënieve financiare të bëra me UK.

## **Neni 3** **Kriteret për përfitimin e lejes sabatike**

1. Për t'u kualifikuar për lejen sabatike, anëtarët e stafit akademik duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a. t'i përkasin kategorisë "Profesor" dhe "Lektor";
  - b. të kenë qenë të punësuar si staf akademik me kohë të plotë për së paku 7 vitet e fundit;
  - c. të kenë paraqitur raportin përfundimtar për lejen e mëparshme sabatike, në rastin kur ka qenë përfitues;
  - d. gjatë periudhës së aplikimit për vitin sabatik të mos kenë masë disiplinore të pashlyer.
2. Autoritetet drejtuese të UK-së, kanë të drejtë aplikojnë për lejen sabatike me kusht dorëheqjen nga pozicioni drejtues.
3. Nuk ka të drejtë të aplikojë për vitin sabatik niesa e stafit akademik të cilit i kanë mbetur vetëm...

vjet nga mosha e pensionimit në kohën kur bëhet aplikimi.



#### **Neni 4 Përlllogaritja e vitit sabatik**

1. Viti sabatik mund të përdoret i plotë (12 muaj) ose i pjesshëm (6 muaj).
2. Lejet sabatike do të jepen për:
  - a. një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh, ose
  - b. dy (2) periudha prej gjashtë (6) muajsh në vite të ndryshme akademike, të cilat do të fillojnë dhe do të përfundojnë me fillimin dhe përfundimin e semestrit të vitit akademik përkatës.
3. Nëse leja sabatike jepet për më pak se dymbëdhjetë (12) muaj, muajt e tjerë nuk do të shtohen, ose të barten në lejen e ardhshme sabatike.
4. Në rastin kur anëtari i stafit akademik i ka shkëputur marrëdhëniet akademike me UK (leje lindjeje, bursë për studime pasuniversitare, bursë për rritjen e kapaciteteve profesionale), këtij subjekti i lind detyrimi i angazhimit në veprimtaritë e UK-së për një periudhë 1 (një) vjeçare para aplikimit për vitin akademik sabatik.

#### **Neni 5 Masat për zëvendësimin e personelit akademik**

1. Njësia bazë, në rast se e shikon të arsyeshme, bën rishpërndarjen e ngarkesës akademike në auditor të personelit që do të përdorë lejen sabatike ndërmjet anëtarëve të tjerë të njësisë.
2. Personeli akademik që përfiton vitin sabatik mund të zëvendësohet nga staf akademik me kohë të pjesshme për të përmbushur ngarkesën mësimdhënëse në auditor.

#### **Neni 6 Procedura e aplikimit**

1. Anëtari i stafit akademik duhet të bëjë kërkesën për vitin sabatik duke plotësuar "Formularin e Aplikimit për Vitin Akademik Sabatik", të disponueshëm nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
2. Personeli akademik që aplikon për dy semestra njëri pas tjetrit duhet të plotësojë një formular aplikimi.
3. Personeli akademik që aplikon për dy semestra në vite të ndryshme akademike duhet të plotësojë dy formularë.
4. Kur personeli akademik që aplikon për vitin sabatik është i angazhuar në mësimdhënie në më shumë se një njësi bazë, atëherë njoftimi do t'u dërgohet edhe njësive bazë ku e shtrin veprimtarinë aplikanti.
5. Kërkesa për lejen sabatike depozitohet tek përgjegjësi i njësisë bazë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, të paktën dy muaj para fillimit të vitit sabatik.
6. Dokumentacioni shoqërues i kërkesës përfshin:
  - a. Planin e vitit sabatik, i cili përshkruan veprimtaritë e parashikuara gjatë kësaj periudhe dhe përmban:
    - qëllimet akademike ose objektivat e planifikuara për t'u përmbushur gjatë vitit sabatik;
    - rëndësinë e veprimtarisë/veprimtarive të planifikuara dhe ndikimi i tyre në punën e njësisë bazë/UK-së.
    - rezultatet e pritshme të objektivave të parashtruara.



- produktin e kërkimit shkencor.
  - b. një Currulum Vitate akademike të përditësuar;
  - c. deklaratën për vendin dhe kohën kur dhe ku do të përdoret viti sabatik;
  - d. ftesën nga institucioni/et të cilat personeli akademik synon të vizitojë gjatë vitit sabatik (nëse është planifikuar);
  - e. një kopje të raportit të dorëzuar në përfundim të vitit të mëparshëm sabatik të përdorur nga ky personel (nëse është përdorur).
7. Kërkesa e paraqitur pranë departamentit regjistrohet në regjistrin elektronik të lejeve për vitin sabatik.
8. Përgjegjësi i departamentit, pasi ka marrë vendimin e njësisë bazë, për pranimin ose mospranimin e kërkesë, brenda një afati prej 30 ditësh, njofton drejtuesin e njësisë kryesore dhe rektorin e UK-së.
9. Personeli akademik, përfitues i vitit sabatik, me miratimin përfundimtar të rektorit të UK-së, lidh një kontratë të veçantë me UK-në në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet konkrete të palëve nënshkruese të kontratës, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

### **Neni 7**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e personelit përfitues**

1. Personeli përfitues i vitit akademik sabatik ka këto të drejta dhe detyrime ndaj UK-së:
- a. Gjatë periudhës së përdorimit të vitit akademik sabatik personeli akademik, përfitues i vitit sabatik, është i liruar nga detyrimet e organizimit të vitit akademik.
  - b. Gjatë vitit akademik sabatik, anëtari i personelit akademik paguhet me 100 për qind të pagës. Në rast se për veprimtaritë e parashikuara gjatë këtij viti, personeli akademik do të marrë mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, ose nga palë të treta, pagesa e tij do të përlllogaritet duke mos kapërcyer limitin e pagës së tij vjetore. Në këtë rast, Bordi i Administrimit miraton masën e pagesës vjetore të personelit akademik mbështetur në propozimin e rektorit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
  - c. Në rast se anëtari i personelit akademik kërkon edhe mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, propozimi i kalon edhe Bordit të Administrimit për miratimin e pjesës financiare.
  - d. Mosrealizimi i objektit të vitit sabatik, sipas planit të miratuar, përbën shkak për përgjegjësi disiplinore, si dhe detyron të rimbursojë të gjitha përfitimet financiare që ka marrë.
  - e. Pas përfundimit të vitit sabatik, të qëndrojë në institucion për të paktën tre vjet, në të kundërt detyrohet të rimbursojë të gjitha përfitimet financiare që ka marrë.
  - f. Të raportojë një herë në tre muaj për arritjen e objektivave të përcaktuara në planin e vitit sabatik.

### **Neni 8**

#### **Të drejtat dhe detyrimet e UK-së**

1. Universiteti gjatë vitit sabatik ka këto të drejta dhe detyrime ndaj personelit akademik përfitues:
- a. Gjatë periudhës së vitit akademik sabatik nuk do t'i ngarkojë personelit përfitues asnjë detyrim akademik dhe/ose institucional.
  - b. Do të paguajë personelin përfitues me 100% të pagës. Në rast se për veprimtaritë e parashikuara gjatë këtij viti, personeli akademik do të marrë mbështetje financiare në përputhje me zërat buxhetorë të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë qëllim, ose nga palë të treta, pagesa e tij do të përlllogaritet duke mos kapërcyer limitin e pagës së tij vjetore.

merr financim nga UK-ja dhe/ose nga palë të treta për realizimin e veprimtarive të parashikuara.  
d. Mënyra e kontrollit të cilësisë së objektit që duhet të realizohet gjatë vitit sabbatik bëhet në përputhje me parashikimet e rregullores së njësisë bazë, sipas vlerësimit të bërë nga përgjegjësi i departamentit.



**Neni 9**  
**Juridiksioni**

1. Kjo rregullore i bashkëngjitet akteve të tjera të brendshme të UK-së dhe e shtrin veprimin e saj mbi të gjitha njësitë përbërëse të Universitetit.

**REKTORI**  
**PROF. DR. ALI JASHARI**





## FORMULAR APLIKIMI PËR VITIN AKADEMIK SABATIK

\*Formulari do të jetë individual.

\*Formulari i plotësuar nga aplikanti të dorëzohet pranë përgjegjësit të njësisë kryesore përkatëse

### TË DHËNA PERSONALE

Titulli/Grada: \_\_\_\_\_

Emër: \_\_\_\_\_

Mbiemër: \_\_\_\_\_

Kategoria: \_\_\_\_\_

Njësia kryesore/njësia bazë:  
\_\_\_\_\_

Datë: \_\_\_\_\_

### VITI I MËPARSHËM SABATIK

Përshkruani me hollësi veprimtaritë dhe rezultatet e arritura nga përfitimi i vitit të mëparshëm sabatik (të shoqërohet me raportin përfundimtar përkatës):

### VEPRIMTARITË E PROPOZUARA DHE REZULTATET E PRITSHME

Koha e propozuar: Nga \_\_\_\_\_ Deri në \_\_\_\_\_

Ju lutemi jepni detaje të hollësishme për veprimtaritë që do të ndërmerren dhe rezultatet e pritura. Specifikoni nëse për realizimin e tyre do të merret financim nga UK apo palë të treta.

### PËRFITIMET PËR UK-në

Ju lutemi argumentoni sesi rezultatet e propozuara prej jush ndihmojnë në zhvillimin e njësisë bazë dhe në realizimin e planit strategjik të UK-së.

### MBËSHTETJA FINANCIARE

Ju lutemi deklaroni burimin (et) e çdo ndihme financiare që do të merret (e brendshme ose e jashtme)

### ZËVENDËSIMI NË MUNGESË



Ju lutemi jepni detaje për punën tuaj, e cila do të duhet të planifikohet ose të zbatohet nga të tjerët gjatë mungesës tuaj dhe si do të arrihet kjo:

**PËRGJEGJËSI I NJËSISË BAZË**

Të jepet vlerësimi i bërë nga nga njësia bazë.

**Emër Mbiemër:**

**Datë:**

**DEKANI I NJËSISË KRYESORE**

Të jepet vlerësimi i bërë nga titullari i njësive kryesore.

**Emër Mbiemër:**

**Datë:**

**TITULLARI I INSTITUCIONIT**

Të jepet vlerësimi përfundimtar nga titullari i UK-së

**Emër Mbiemër:**

**Datë:**

**Formulari i plotësuar me vlerësimet e titullarëve të njësive dhe institucionit, së bashku me dokumentacionin mbështetës, të dërgohet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1710 prot

Korçë, më 10/10/2019

**VENDIM**

Nr. 535, datë 10.10.2019

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR RREGULLAT DHE STANDARDET E**  
**PËRFITIMIT TË SË DREJTËS PËR VITIN AKADEMIK SABATIK**

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma d) si dhe në Statutin e Universitetit neni 11, pika 6, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 10.10.2019

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren për "Rregullat dhe standardet e përfitimit të së drejtës për vitin akademik sabatik", sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT**

**REKTORI**

Prof. dr. Ali Jashari

